



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 87/10

Prishtinë, më 08.07.2010, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikolić, Myrvete Pantina, Armend Zemaj, Shkumbin Demaliaj, Xhevdet Neziraj, Besa Gaxheri, Suzana Novobërdaliu, Hajdin Abazi, Safete Hadërgjonaj dhe Mufera Sinik.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza zv. Ministër i MEF-it, Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, Ismet Krasniqi – sekretar i Kuvendit të Kosovës, Teki Shala, Ramadan Islami nga GTZ, monitorues nga KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të organizatave buxhetore lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesës tekstuale) për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të organizatave buxhetore lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010

2.1. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit

Bedri Hamza, njoftoi se arsyeja e mos aprovimit të kërkesës së ART-së, ka të bëjë me faktin se nuk mund të aprovojme mjete financiare, kur dihet se nuk mund të realizohen projektet, për periudhën e mbetur. Le të shpenzohen mjetet që kanë në dispozicion për këtë vit, ndërsa kërkesat e tyre do të merren parasysh në vitin 2011.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Buxheti i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit mbetet i njëjtë me atë të propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 dhe i miratuar në parim nga Kuvendi i Kosovës.

2.2. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Pas diskutimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.3. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me ndryshimet e bëra në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.4. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e njëjtat do të pasqyrohet në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.5. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe e njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Zyrës Rregullore për Ujë dhe Mbeturina

Pas diskutimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Buxheti i Zyrës Rregullore për Ujë dhe Mbeturina mbetet i njëjtë me atë të propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 dhe i miratuar në parim nga Kuvendi i Kosovës.

2.7. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komisionit Kosovar të Konkurrencës

Pas diskutimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Buxheti i Komisionit Kosovar të Konkurrencës mbetet i njëjtë me atë të propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 dhe i miratuar në parim nga Kuvendi i Kosovës.

2.8. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Zyrës së Presidentit të Kosovës

Besa Gaxherri nuk pajtua me mënyrën e pagesës së këshilltarëve, si persona politikë. Nuk u pajtua që kjo ndodh edhe në ministrinë tjera. Ky është një veprim i kundërligjshëm.

Agim Krasniqi, theksoi se kemi të bëjmë me një rregullim të brendshëm. Për gjashtë këshilltarët që ka presidenti, kërkohet që të paguhet nga kategoria paga dhe mëditje, ku deri më tani janë paguar nga kategoria mallra dhe shërbime.

Shkumbin Demaliaj, pyeti a paguhet të gjithë këshilltarët e agjencioneve buxhetore njësoj?

Bedri Hamza, duke iu përgjigjur parafolësit, njoftoi se në shumica e ministrive e kanë të kompletuar numrin e punëtorëve në kabinet dhe paguhet nga pagat dhe mëditjet.

Pas diskutimeve, Kryesuesi konstatoi se i me njëmbëdhjetë vota Për, asnjë Abstenim dhe një Kundër (znj. Besa Gaxherri) Komision nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat e Zyrës së Presidentit të Kosovës dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.9. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës

Ismet Krasniqi, pasi arsyetojë kërkesat e paraqitura me shkrim, ajo më e larta ishte kërkesa për renovimin e aneksit të objektit të Kuvendit në vlerë prej 800,000 €.

Bedri Hamza, theksoi se ministria është e gatshme për kërkesa për rregullim të brendshëm. Sa i përket kërkesës së Kuvendit për mallra dhe shërbime, Kuvendi ka fonde të mjaftueshme për këtë vit, për paga dhe mëditje nëse lejohet numri i punëtorëve vitin tjetër do të ketë implikime buxhetore, çka do të vijmë në kundërshtim me rekomandimet e FMN-së. Për investimet kapitale, për projektin në fjalë lë të parashihen 200.000 €, sepse për shkak të procedurave të prokurimit nuk mund të realizohet shuma e kërkuar.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat shtesë e Kuvendit të Kosovës, me ndryshimet e bëra në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohet në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.10. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Pas diskutimeve, Kryesuesi konstatoi se i me dhjetë vota Për, asnjë Abstenim dhe dy Kundër (znj. Besa Gaxherri dhe znj. Suzana Novobërdaliu), Komision nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat shtesë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me ndryshimet e bëra në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.11. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Safete Hadërgjonaj, theksoi se Ministria e Arsimit, në të gjitha komunat ka investuara një shkollë, përveç në komunën e Deçanit.

Pas diskutimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat shtesë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me ndryshimet e bëra në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.12. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Ministrisë së Administratës Publike

Agim Krasniqi, theksoi se është nevoja që të ndahen mjetet për regjistrimin e popullsisë prej 2.1 milion €, e që jemi brenda kufijve të FMN-së. Ndërsa pjesa tjetër janë rregullime të brendshme.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat e Ministrisë së Administratës Publike, me ndryshimet e bëra në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.13. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, me ndryshimet e bëra në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.14. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me ndryshimet e bëra në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.15. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat shitesë e Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, me ndryshimet e bëra në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.16. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahen kërkesat e Ministrisë së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, në Komision dhe të njëjtat do të pasqyrohen në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

2.17. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Komunës së Novo Bërdës

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Përkrahet kërkesa e Komunës së Novo Bërdës dhe e njëjtat do të pasqyrohet në formë të amendamentit në raportin e Komisionit, drejtuar Kuvendit për aprovimin e Projektligjit.

Pas shqyrtimit të kërkesave buxhetore të organizatave buxhetore lidhur me pjesën tabelare të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, Komisioni me shumicë votash, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë pjesën tabelare të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, me amendamentet e propozuara.
- II. Ministria e Ekonomisë dhe Financave të bëjë propozime konkrete për mbulueshmërinë buxhetore të ndryshimeve të bëra në komision, të cilat në formë të amendamenteve, do të jenë pjesë e raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, drejtuar Kuvendit për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

3. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesës tekstuale) për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Miratohet raporti me amendamente për pjesën tekstuale të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-117 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.
- II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë pjesën tekstuale të Projektligjit, me amendamentet e propozuara si në vijim:

Amendamentet 1

Të bëhet harmonizimi i tekstit të projektligjit në versionin në gjuhën serbe dhe angleze me versionin në gjuhën shqipe

Amendamentet 2

Neni 2

Paragrafi 1 që i referohet nenit 10 të Ligjit në fuqi, ndryshohet si në vijim:

1. Secila Organizatë Buxhetore është e obliguar të siguroj se numri i pozitive të saja të punësimit në çdo kohë gjatë vitit fiskal 2010, nuk e tejkalon totalin e numrit të pozitive të punësimit të specifikuar në Tabelat 3.1 dhe 4.1 të bashkangjitur në këtë Ligj. Me përjashtim të Forcës së Sigurimit të Kosovës, ambasadave, agjencive të pavarura dhe të gjitha agjencive tjera të krijuara gjatë vitit 2009 dhe 2010, organizatat qendrore buxhetore nuk mund ta rrisin numrin e të punësuarve të përhershëm të përcaktuar me këtë Ligj, si dhe nuk mund ti rrisin pagat ose shtesat për të punësuarit ekzistues.

“Paragrafi 4” i projektligjit bëhet “**paragrafi 3**”, ndërsa “*paragrafi 3*” i projektligjit bëhet “**paragrafi 4**”.

Amendamentet 3

Neni 5 riformulohet si në vijim:

Neni 5

1. Tabelat e rishikuara të bashkangjitura me këtë ligj janë pjesë e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Amendamentet 4

Neni 6 riformulohet si në vijim:

Neni 6

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e miratimit të tij në Kuvend.

4. Të ndryshme.

Nuk pati ndonjë çështje për tu diskutuar

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Gani Koci
